



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 08.06.2016

Ref.: 410/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), nenin 126 dhe 136 të Ligjit mbi Procedurën Administrative, nr. 02/L-28, datë 22.07.2005, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen e 42-të, të mbajtur më 31 maj 2016, mori:

### V E N D I M

- I. REFUZOHET kërkesa për rishqyrtim të vendimit nr.259/16, e datës 13.05.2016 e Universitetit “Ukshin Hoti”, si e pa bazuar.
- II. Mbetet në fuqi vendimi i KSHC-së nr.240/16, datë 22.04.2016.

### Arsyetimi

Universiteti “Ukshin Hoti”, ka parashtruar kërkesë ( nr.259/16, datë: 13.05.2016) për rishqyrtim të vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) nr.240/16, datë: 22.04.2016, me të cilin është refuzuar aplikacioni për akreditim të programeve të studimit: Edukim Parafillor në Gjuhë Boshnjake, BA (240 ECTS); Edukim Parafillor në Gjuhë Turke, BA (240 ECTS); Edukim Fillor në Gjuhë Boshnjake, BA (240 ECTS); Edukim Fillor në Gjuhë Turke, BA (240 ECTS).

Sipas vendimit të KSHC-së nr.240/16, datë 22.04.2016, Universiteti “Ukshin Hoti” nuk ka plotësuar kriteret e parapara sipas nenit 11, pika 3.2 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim (UA) nr. 02/2013, datë 16.01.2013, ku sipas kësaj pike, institucioni duhet të ketë të paktën tre PhD (Dr.sc.) në marrëdhënie të rregullt pune për secilin program studimi.

KSHC ka shqyrtuar kërkesën (nr.259/16, datë: 13.05.2016) e Universitetit “Ukshin Hoti” për rishqyrtim të vendimit, dhe ka konsideruar se Universiteti i Prizrenit nuk ka ofruar asnjë dëshmi me të cilën do ta argumentonte plotësimin e kriterëve që parashihen për një program të studimit sipas nenit 11, pika 3.2 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim (UA) nr. 02/2013, datë 16.01.2013. Si rezultat i mos përmbushjes së kriterëve që parashihen në Udhëzimin Administrativ për Akreditim, u vendos si në diapozitiv të këtij vendimi ku KSHC mori vendim për refuzimin e kërkesës së Universitetit “Ukshin Hoti”.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”;
- Arkivit të AKA-së.
- MASHT

---

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë